



**UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY**

Zija Shemsiu pn., 60000, Gjiilan, Republika e Kosovës  
www.uni-gjiilan.net tel: 0280390112

---

**Ref. nr. 01/2913      Dt. 18/12/2023**

**RREGULLORE**

**PER SIGURIMIN E CILËSISË DHE VLERËSIMIT NË UNIVERSITETIN PUBLIK  
"KADRI ZEKA"- GJILAN**

**Gjiilan, 18 dhjetor 2023**

Në bazë të nenit 48 paragrafi 1 nwnparagrafi 1.9 të Statutit të Universiteti "Kadri Zeka" Gjiilan, Senati i Universiteti "Kadri Zeka" në mbledhjen e mbajtur më 18. 12. 2023miratoi këtë:

**Neni 1**

**Qëllimi**

Rregullorja ka për qëllim përcaktimin e sistemit të sigurim të cilësisë dhe vlerësimit, mekanizmat dhe instrumentet e sigurimit të cilësisë, akterëve të sigurimit të cilësisë dhe përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësi të palëve të përfshira në këtë proces. Ky proces ka për qëllim arritjen e objektivave strategjike të Universitetit.

**Neni 2**

**Objektivat e sistemit të sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit nw UKZ**

1. Proceset e sigurimit të cilësisë brenda universitetit të jenë aktivitete të rregullta që kontribuojnë në zhvillimin e kulturës së cilësisë brenda universitetit.
2. Rezultatet e proceseve të sigurimit të clësisë të shërbejnë si udhërrëfyes për vendimmarrje dhe planifikim strategjik të universitetit.

3. Ndërgjegjësimi i secilit pjesëtar të komunitetit akademik dhe administrativ brenda universitetit për detyrat dhe obligimet e tyre karshi proceseve të sigurimit të cilësisë.
4. Përfshirje aktive e komunitetit akademik, administrativ, studentëve dhe akterëve tjerë në proceset e sigurimit të cilësisë.
5. Rritja e transparencës dhe kredibilitetit të proceseve të sigurimit të cilësisë.

### **Neni 3**

#### **Fushat e Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit**

1. Me këtë Rregullore përcaktohet sigurimi dhe vetëvlerësimi i cilësisë në këto fusha:
  - 1.1. Vetëvlerësimi në nivel institucional.
  - 1.2. Vetëvlerësimi në nivel të programeve studimore.
  - 1.3. Hartimi dhe miratimi i programeve të reja studimore.
  - 1.4. Vlerësimi i procesit mësimor, kërkimit shkencor, artistik, i administratës, stafit akademik dhe gjitha fushave të tjera të veprimtarisë së Universitetit.
  - 1.5. Rishikimi i vazhdueshëm i programeve të studimit.
  - 1.6. Vlerësimi i jashtëm i sigurimit të cilësisë.
  - 1.7. Mobiliteti, bashkëpunimi ndërkombëtar dhe ndërkombëtarizimi.
  - 1.8. Teksteve mësimore, literatura, biblioteka dhe infrastrukturës mësimore.
  - 1.9. Mbështetja financiare.
  - 1.10. Fusha të tjera sipas nevojës apo kërkesave të ndryshme nga MASHT, Agjencia e Kosovës për Akreditim, etj.

### **Neni 4**

#### **Llojet e vlerësimeve**

1. Në UKZ praktikohen:
  - 1.1. Vlerësimet e brendshme dhe
  - 1.2. Vlerësimet e jashtme
2. Vlerësimet e brendshme bëhen përmes studentëve, stafit akademik, punëdhënësve, alumni, palëve të jashtme të interesit të tjerë të Universitetit.
3. Vlerësimet e jashtme bëhen nga autoritetet shtetërore, si Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) ose ndonjë agjenci tjetër ndërkombëtare e cila njihet sipas dispozitave të Ligjit të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës.

## **Neni 5**

### **Instrumentet për Vlerësim të Brendshëm të Cilësisë**

#### **1. Pyetësorët:**

- 1.1. Pyetëtori — Dekani vlerëson Stafin Akademik
- 1.2. Pyetëtori — Vetëvlerësimi i Stafit Akademik
- 1.3. Pyetëtori — Studenti vlerëson Stafin Akademik dhe lëndët
- 1.4. Pyetëtori — Studenti vlerëson Administratën
- 1.5. Pyetëtori — Punëdhënësi vlerëson Stafin Akademik dhe Administrativ
- 1.6. Pyetëtori — Të Diplomuarit (Alumni)

#### **2. Instrumentet tjera:**

- 2.1. Fokus grupet
- 2.2. Vlerësimi i kolegut për kolegun.

## **Neni 6**

### **Vlerësimi i jashtëm i cilësisë**

#### **1. Vlerësimi i jashtëm mund të bëhet:**

- 1.1. Me nismën e Këshillit Drejtues, Senatit ose Rektorit;
- 1.2. Me nismën e Këshillit të NJA;
- 1.3. Me nismën e Ministrisë së Arsimit;
- 1.4. Sipas kohëzgjatjes së akreditimit nga AKA;
2. Të gjitha njësitë e Universitetit dhe organet e tyre, janë të detyruara të sigurojnë të dhënat e nevojshme dhe informatat për vlerësim dhe të bashkëpunojnë ngushtë me Organet e Sistemit të Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit në UKZ.

## **Neni 7**

### **Afati/ Periudha e Vlerësimit**

1. Afatet dhe periudhat e vlerësimit të cilësisë përcaktohen në kalendarin e aktiviteteve për proceset e sigurimit të cilësisë i hartuar nga Këshilli për Mbikëqyrjen e Cilësisë dhe Vlerësimit (në tekstin e mëtejshëm: KMCV)
2. Mekanizmat institucional janë përgjegjës për procesin e vlerësimit, dhe para se të bëhet vlerësimi i informojnë njësitë përkatëse të universitetit, për:
  - 2.1. Fushat e vlerësimit;
  - 2.2. Procedurat dhe oraret e vlerësimit;
  - 2.3. Instrumentet e vlerësimit.

## **Neni 8**

### **Format e Vlerësimit**

1. Vlerësimi i Cilësisë do të bëhet përmes sistemit online dhe fizik për fushat e parapara në këtë rregullore.
2. Grumbullimi dhe ruajtja e të dhënave nga proceset e vlerësimit do të bëhen në databazën për cilësi në kuadër të UKZ-së.

## **Neni 9**

### **Organet e Sistemit të Sigurimit të cilësisë dhe Vlerësimit në UKZ**

1. Rektori;
2. Senati;
3. Dekanët;
4. Këshilli për Mbikëqyrjen e Cilësisë dhe Vlerësimit;
5. Zyra për Zhvillim Akademik dhe Cilësisë.
6. Koordinatorët për Cilësi dhe Akreditim nga çdo njësi akademike,
7. Komisionet (ad-hoc).

## **Neni 10**

### **Rektori**

1. Rektori sigurohet që ekzistojnë kushtet e duhura për realizimin e aktiviteteve të vlerësimit brenda sistemit të sigurimit të cilësisë.
2. Rektori siguron mbështetjen e nevojshme financiare për të realizuar aktivitetet e vlerësimit brenda sigurimit të cilësisë.
3. Rektori së bashku me pjesën tjetër të menaxhmentit siguron që rezultatet e vlerësimeve dhe masat e propozuara nga KMCV-të t'i shdërrojnë në masa operative për përmisimet e nevojshme.



**UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY**

Zija Shemsiu pn., 60000, Gjiilan, Republika e Kosovës  
www.uni-gjiilan.net tel: 0280390112

---

**Ref. nr. 01/2913      Dt. 18/12/2023**

**RREGULLORE**

**PER SIGURIMIN E CILËSISË DHE VLERËSIMIT NË UNIVERSITETIN PUBLIK  
"KADRI ZEKA"- GJILAN**

**Gjiilan, 18 dhjetor 2023**

Në bazë të nenit 48 paragrafi 1 nwnparagrafi 1.9 të Statutit të Universiteti "Kadri Zeka" Gjiilan, Senati i Universiteti "Kadri Zeka" në mbledhjen e mbajtur më 18. 12. 2023miratoi këtë:

**Neni 1**

**Qëllimi**

Rregullorja ka për qëllim përcaktimin e sistemit të sigurim të cilësisë dhe vlerësimit, mekanizmat dhe instrumentet e sigurimit të cilësisë, akterëve të sigurimit të cilësisë dhe përcaktimin e detyrave dhe përgjegjësi të palëve të përfshira në këtë proces. Ky proces ka për qëllim arritjen e objektivave strategjike të Universitetit.

**Neni 2**

**Objektivat e sistemit të sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit nw UKZ**

1. Proceset e sigurimit të cilësisë brenda universitetit të jenë aktivitete të rregullta që kontribuojnë në zhvillimin e kulturës së cilësisë brenda universitetit.
2. Rezultatet e proceseve të sigurimit të clësisë të shërbejnë si udhërrëfyes për vendimmarrje dhe planifikim strategjik të universitetit.

3. Ndërgjegjësimi i secilit pjesëtar të komunitetit akademik dhe administrativ brenda universitetit për detyrat dhe obligimet e tyre karshi proceseve të sigurimit të cilësisë.
4. Përfshirje aktive e komunitetit akademik, administrativ, studentëve dhe akterëve tjerë në proceset e sigurimit të cilësisë.
5. Rritja e transparencës dhe kredibilitetit të proceseve të sigurimit të cilësisë.

### **Neni 3**

#### **Fushat e Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit**

1. Me këtë Rregullore përcaktohet sigurimi dhe vetëvlerësimi i cilësisë në këto fusha:
  - 1.1. Vetëvlerësimi në nivel institucional.
  - 1.2. Vetëvlerësimi në nivel të programeve studimore.
  - 1.3. Hartimi dhe miratimi i programeve të reja studimore.
  - 1.4. Vlerësimi i procesit mësimor, kërkimit shkencor, artistik, i administratës, stafit akademik dhe gjitha fushave të tjera të veprimtarisë së Universitetit.
  - 1.5. Rishikimi i vazhdueshëm i programeve të studimit.
  - 1.6. Vlerësimi i jashtëm i sigurimit të cilësisë.
  - 1.7. Mobiliteti, bashkëpunimi ndërkombëtar dhe ndërkombëtarizimi.
  - 1.8. Teksteve mësimore, literatura, biblioteka dhe infrastrukturës mësimore.
  - 1.9. Mbështetja financiare.
  - 1.10. Fusha të tjera sipas nevojës apo kërkesave të ndryshme nga MASHT, Agjencia e Kosovës për Akreditim, etj.

### **Neni 4**

#### **Llojet e vlerësimeve**

1. Në UKZ praktikohen:
  - 1.1. Vlerësimet e brendshme dhe
  - 1.2. Vlerësimet e jashtme
2. Vlerësimet e brendshme bëhen përmes studentëve, stafit akademik, punëdhënësve, alumni, palëve të jashtme të interesit të tjerë të Universitetit.
3. Vlerësimet e jashtme bëhen nga autoritetet shtetërore, si Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) ose ndonjë agjenci tjetër ndërkombëtare e cila njihet sipas dispozitave të Ligjit të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës.

## **Neni 5**

### **Instrumentet për Vlerësim të Brendshëm të Cilësisë**

#### **1. Pyetësorët:**

- 1.1. Pyetësori — Dekani vlerëson Stafin Akademik
- 1.2. Pyetësori — Vetëvlerësimi i Stafit Akademik
- 1.3. Pyetësori — Studenti vlerëson Stafin Akademik dhe lëndët
- 1.4. Pyetësori — Studenti vlerëson Administratën
- 1.5. Pyetësori — Punëdhënësi vlerëson Stafin Akademik dhe Administrativ
- 1.6. Pyetësori — Të Diplomuarit (Alumni)

#### **2. Instrumentet tjera:**

- 2.1. Fokus grupet
- 2.2. Vlerësimi i kolegut për kolegun.

## **Neni 6**

### **Vlerësimi i jashtëm i cilësisë**

#### **1. Vlerësimi i jashtëm mund të bëhet:**

- 1.1. Me nismën e Këshillit Drejtues, Senatit ose Rektorit;
- 1.2. Me nismën e Këshillit të NJA;
- 1.3. Me nismën e Ministrisë së Arsimit;
- 1.4. Sipas kohëzgjatjes së akreditimit nga AKA;

#### **2. Të gjitha njësitë e Universitetit dhe organet e tyre, janë të detyruara të sigurojnë të dhënat e nevojshme dhe informatat për vlerësim dhe të bashkëpunojnë ngushtë me Organet e Sistemit të Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimit në UKZ.**

## **Neni 7**

### **Afati/ Periudha e Vlerësimit**

1. Afatet dhe periudhat e vlerësimit të cilësisë përcaktohen në kalendarin e aktiviteteve për proceset e sigurimit të cilësisë i hartuar nga Këshilli për Mbikëqyrjen e Cilësisë dhe Vlerësimit (në tekstin e mëtejshëm: KMCV)
2. Mekanizmat institucional janë përgjegjës për procesin e vlerësimit, dhe para se të bëhet vlerësimi i informojnë njësitë përkatëse të universitetit, për:
  - 2.1. Fushat e vlerësimit;
  - 2.2. Procedurat dhe oraret e vlerësimit;
  - 2.3. Instrumentet e vlerësimit.

## **Neni 8**

### **Format e Vlerësimit**

1. Vlerësimi i Cilësisë do të bëhet përmes sistemit online dhe fizik për fushat e parapara në këtë rregullorë.
2. Grumbullimi dhe ruajtja e të dhënave nga proceset e vlerësimit do të bëhen në databazën për cilësi në kuadër të UKZ-së.

## **Neni 9**

### **Organet e Sistemit të Sigurimit të cilësisë dhe Vlerësimit në UKZ**

1. Rektori;
2. Senati;
3. Dekanët;
4. Këshilli për Mbikëqyrjen e Cilësisë dhe Vlerësimit;
5. Zyra për Zhvillim Akademik dhe Cilësisë.
6. Koordinatorët për Cilësi dhe Akreditim nga çdo njësi akademike,
7. Komisionet (ad-hoc).

## **Neni 10**

### **Rektori**

1. Rektori sigurohet që ekzistojnë kushtet e duhura për realizimin e aktiviteteve të vlerësimit brenda sistemit të sigurimit të cilësisë.
2. Rektori siguron mbështetjen e nevojshme financiare për të realizuar aktivitetet e vlerësimit brenda sigurimit të cilësisë.
3. Rektori së bashku me pjesën tjetër të menaxhmentit siguron që rezultatet e vlerësimeve dhe masat e propozuara nga KMCV-të t'i shpërndajë në masa operative për përmisimet e nevojshme.

## **Neni 11**

### **Këshilli Mbikëqyrës i Cilësisë dhe Vlerësimit**

1. KMCV është organ këshillues i Senatit dhe Rektorit, i cili në bashkëpunim me organe tjera mbështetëse dhe profesionale të Universitetit nga neni 9 i kësaj Rregulloreje, planifikon, harton, monitoron, analizon dhe administron procedurat e vlerësimit të procesit mësimor, hulumtimit shkencor, dhe të gjitha vlerësimet e fushave të tjera që mbulohen nga universiteti.
2. Anëtarët e KMCV janë:
  - 2.1 Prorektori për Zhvillim Akademik dhe Cilësi (i përhershëm) Kryesues.
  - 2.2 Prodekanët për Çështje Mësimore nga secila Njësi Akademike.
  - 2.3 Drejtori i Zyrës për Zhvillim Akademik dhe Cilësi (i përhershëm) pa të drejtë vote.
  - 2.4 Zyrtari për Çështje Akademike (i përhershëm) pa të drejtë vote.
  - 2.5 Dy studentë me sukses të shkelqyeshëm.
3. Anëtarët jo të përhershëm do të votohen nga Senati i Universitetit për një mandat katër (4) vjeçar, përveç përfaqësuesve të studentëve që zgjat njw (1) vit.
4. Në rastet kur votimi është i barabartë, vota e kryesuesit është vendimtare.
5. KMCV harton dhe aprovon Rregulloren e punës së këtij komisioni i cili është dokument publik i Universitetit.
6. Komisioni për punën e vet i raporton Senatit.

## **Neni 12**

### **Detyrat e Këshillit Mbikëqyrës të Cilësisë dhe Vlerësimit**

1. I propozon Rektorit dhe Senatit një strategji me udhëzimet e sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit, kriteret, standardet dhe procedurat për realizimin e saj dhe përmirësimin e vazhdueshëm.
2. Harton Manualin e Sigurimit të Cilësisë
3. Harton dhe aprovon planin e aktiviteteve për sigurimin e cilësisë në përputhje me rregullativën në fuqi dhe dokumentin strategjik të UKZ-së.
4. I dorëzon Rektorit dhe Senatit raport mbi planin e realizuar në aspektin e Sigurimit të cilësisë.
5. I jep sugjerime Rektorit, Senatit, Dekanëve të njësive akademike, për përmisim të nivelit të cilësisë.
6. Inkurajon diskutimet për cilësinë dhe promovon kulturën e cilësisë bnda universitetit.
7. Analizon të dhënat e mbledhura në fushat e nenit 3 të kësaj Rregulloreje.

8. Harton dhe i propozon Senatit aprovimin e raportit të vetëvlerësimit për Ri/Akreditim Institucional.
9. Shqyrton dhe i propozon Senatit aprovimin e raporteve të vetëvlerësimit për Ri/Akreditim të Programeve Studimore.
10. Në bashkëpunim me menaxhmentin e lartë dhe dekanët zgjedhë anëtarët e komisioneve ad-hoc për realizimin e vlerësimeve sipas nevojës.
11. Harton raporte të përmisimit në bazë të të dhënave dhe vlerësimeve të pranuar nga Zyra për Zhvillim Akademik dhe Cilësi.
12. Harton raporte të përmisimit në bazë të vlerësimeve të Komisioneve ad hoc, të cilat bëjnë vlerësim të brendshëm periodik të programeve aktuale të studimit, dhe ia paraqet Këshillit të Fakulteteve dhe Menaxhmentit të Lartë.
13. Analizon dhe aprovon raporte periodike/vjetore dhe planet e veprimtarisë së sistemit të sigurimit të cilësisë së njësive akademike të Universitetit, të cilat raporte i dërgon tek Menxhmenti i Lartë.

### **Neni 13**

#### **Zyra për Zhvillim Akademik dhe Cilësi**

1. Zyra për Zhvillim Akademik dhe Cilësi është zyra qendrore e sigurimit të cilësisë në kuadër të Universitetit.
2. Zyra për Zhvillim Akademik dhe Cilësi përbëhet nga:
  - 2.1. Drejtori i ZZHAC;
  - 2.2. Zyrtari për kërkime shkencore;
  - 2.3. Zyrtari për sigurim të cilësisë;
  - 2.4. Zyrtari për akreditim dhe certifikim;
  - 2.5. Zyrtari për zhvillim të karrierës.
3. Koordinatorë për Cilësi dhe Akreditim nga secila njësi akademike.

### **Neni 14**

#### **Detyrat e Zyrës për Zhvillim Akademik dhe Cilësi**

1. Zyra është mbështetëse e KMCV —së në iniciimin dhe koordinimin e iniciativave dhe në zbatimin e vazhdueshëm për sigurim të cilësisë.
2. Zyra organizon një monitorim sistematik të treguesve të miratuar të cilësisë si në vijim:
  - 2.1. Implementon Pianin e Sigurimit të Cilësisë.

- 2.2. Mbledh informacione për cilësi dhe vlerësim nga të gjithë mekanizmat brenda universitetit.
- 2.3. Në bashkëpunim me KMCV organizon procesin e vlerësimit të brendshëm sipas Manualit për Sigurim të Cilësisë, përmes pyetësorëve dhe instrumenteve të tjera të parapara në Manual.
- 2.4. Shpërndan pyetësorët, mbledh, përpunon dhe vlerëson të dhënat nga fushat e vlerësuara sipas nenit 3 të kësaj rregulloreje.
- 2.5. Ofron mbështetje për Komisionet ad-hoc në procesin e vlerësimit të ndrvshimeve dhe plotësimeve në programet ekzistuese të studimit, si dhe në procedura të vlerësimit të brendshëm periodik.
- 2.6. Ofron mbështetje administrative në procedurat e vlerësimit të brendshëm të sistemit të sigurimit të cilësisë së Universitetit.
- 2.7. I ofron mbështetje njësive akademike përmes Koordinatorëve për Cilësi dhe Akreditim.
- 2.8. Mbledh, përpunon dhe analizon të dhënat e nevojshme për përpilimin e raportit vjetor të punës.
- 2.9. Koordinon punën në mbështetje të Njësive Akademike për procesin e Ri/Akreditimit Institucional dhe të Ri/Akreditimit të programeve studimore bazuar në Udhëzuesit dhe standardet e AKA-së.
- 2.10. Mirëmban dhe i shqyrton dokumentacionin e procesit të ri /akreditimit, përgatitë raporte dhe analiza përkatëse.
3. Zyra bashkëpunon me të gjitha organet përgjegjëse për sigurimin dhe përmisimin e cilësisë në UKZ.
4. Zyra vepron në përputhje me Planin Strategjik të UKZ-së, Strategjinë për Sigurim të Cilësisë si dhe Planin e Veprimit për Cilësi.

## **Neni 15**

### **Dekanët**

1. Dekani i njësisë akademike sigurohet që ekzistojnë kushtet e duhura për realizimin me sukses dhe sipas planifikimit të aktiviteteve të vlerësimit brenda sistemit të sigurimit të cilësisë të njësisë akademike.
2. Dekani i njësisë akademike siguron qasje në të dhënat për vlerësimet që bëhen në kuadër të kësaj rregulloreje.
3. Dekani i NJA zbaton planin e përmisimit sipas udhëzimeve të menaxhmentit, pas secilit aktivitet të vlerësimit dhe reflekton në përmisimin e cilësisë.
4. Dekanët e NJA sipas nevojës apo propozimit të KMCV-së, formojnë komisione ad-hoc, për vlerësime të cilësisë sipas nevojës.

## **Neni 16**

### **Koordinatori për Cilësi dhe Akreditim në njësi akademike**

1. Secila Njësi Akademike e Universitetit ka një Koordinator për Cilësi dhe Akreditim.
2. Koordinatori për Cilësi dhe Akreditim do të jetë pjesë e Stafit Akademik.
3. Koordinatori për Cilësi dhe Akreditim do të implementojë aktivitetet e parapara në kalendarin e aktiviteteve për sigurim të cilësisë dhe do të jetë në mbështetje të vazhdueshme të Zyrës për Zhvillim Akademik dhe Cilësi.
4. Koordinatori për cilësi dhe Akreditim për punën e tij në sigurimin e cilësisë i raporton Dekanin të NJA dhe Drejtorin të Zyrës për Zhvillim Akademik dhe Cilësi.
5. Detyrat e Koordinatorit për Cilësi dhe Akreditim të NJA, do të parashihen me Udhëzuesin për Sigurim të Cilësisë.


## **Neni 17**

### **Raportimi**

1. Zyra mbledh rezultatet e vlerësimit periodik/vjetor dhe planet e veprimtarisë së sistemit të sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit të njësive akademike të Universitetit, dhe rezultatet e vlerësimeve i dërgon te KMCV.
2. KMCV është përgjegjës që pas pranimit të rezultateve të vlerësimeve nga Zyra, të hartojë raportet përfundimtare të vlerësimit, të cilat do t'iu prezantohen menaxhmentit të UKZ.
3. Raportet përfundimtare duhet të përmbajnë:
  - 3.1 Procedurën e Vlerësimit;
  - 3.2 Rezultatet e Vlerësimit;
  - 3.3 Rekomandimet e propozuara;
  - 3.4 Kohën e Implementimit të Rekomandimeve të Propozuara.
  - 3.5 Pas pranimit të raportit nga menaxhmenti, Rektori do të kërkojë zbatimin e tij nga autoritetet drejtuese në nivel Universiteti, dhe në nivel të njësive akademike sipas kornizës kohore të propozuar nga Këshilli.
  - 3.6 Përmbledhjet e vlerësimeve në formë të raporteve do të publikohen përmes uebfaqes zyrtare të UKZ-së apo përmes kanaleve të tjera të brendshme të informimit të universitetit.

### Neni 18

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit në Senatin e Universitetin "Kadri Zeka" në Gjiilan.



Kryesuesi i Senatit

Prof. Asoc. Dr. Artan Dermaku

